

VENDIM
Nr. 352, datë 4.4.2019

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN DHE
NEGOCIMIN E KONTRATËS, ME OBJEKT REALIZIMIN E PROJEKTIT TË
ZHVILLIMIT TË ZONËS SË TEATRIT KOMBËTAR, PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
KUALIFIKUESE DHE VLERËSUESE PËR PËRZGJEDHJEN E PALËS PRIVATE PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT URBAN DHE GODINËS SË RE TË TEATRIT
KOMBËTAR, SI DHE HARTIMIN E KONTRATËS PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
TË ZHVILLIMIT TË ZONËS SË TEATRIT KOMBËTAR, PËRFSHIRË
PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE DORËZIMIN E GODINËS SË RE TË TEATRIT
KOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 5, dhe pikave 3, 13 dhe 15, të nenit 7, të ligjit nr. 37/2018, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Ky vendim ka për qëllim:

a) krijimin e komisionit për realizimin e procedurave të vlerësimit dhe të negociimit të kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e kontratës me palën private të përzgjedhur;

b) përcaktimin e kriterëve kualifikuesë e vlerësuesë dhe dokumentacionin e kërkuar për përzgjedhjen e palës private që do të marrë përsipër realizimin e projektit të zhvillimit të zonës dhe të godinës së re të Teatrit Kombëtar.

II. KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE NEGOCIMIT

1. Komisioni i vlerësimit dhe negociimit (komisioni) kryesohet nga zëvendëskryetari i Bashkisë së Tiranës dhe përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- a) Ministria e Kulturës;
- b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ç) Ministria e Drejtësisë;
- d) Avokatura e Shtetit;
- dh) Trupa teatrore.

2. Anëtarët e këtij komisioni përzgjidhen sipas fushës së kompetencës dhe përgjegjësisë së institucionit që përfaqësojnë.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij kreu, dërgojnë pranë Bashkisë së Tiranës emrat e anëtarëve përfaqësues në këtë komision. Kryetari i komisionit thërret mbledhjen e parë brenda 5 (pesë) ditëve nga dërgimi i emrave të anëtarëve.

4. Në mbledhjen e tij të parë, me propozim të kryetarit, komisioni cakton në rolin e sekretariatit 3 (tri) përfaqësues nga Bashkia e Tiranës. Sekretariati i komisionit është përgjegjës për hartimin dhe administrimin e të gjitha procesverbaleve e dokumenteve të procedurës, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me procedurën e përcaktimit e të negociimit të kushteve të kontratës, sipas vullnetit

dhe vendimmarrjes së shprehur nga komisioni, përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 37/2018.

5. Me propozim të çdo anëtar i komisionit ose me iniciativë të tij, kryetari i komisionit thërret ekspertë të fushës apo përfaqësues nga institucione të tjera për të dhënë mendimin/ekspertizën e kërkuar, sipas fushës së përgjegjësisë të institucioneve që ato përfaqësojnë.

6. Çdo institucion apo ent shtetëror, sipas kërkesës së komisionit, është i detyruar që brenda 3 (tri) ditëve nga kërkesa të vendosë në dispozicion të komisionit ekspertizën e kërkuar, nëpërmjet dërgimit të ekspertëve apo dhënien e saj me shkrim. Çdo qëndrim i ekspertëve të thirrur në komision pasqyrohet në procesverbal dhe një kopje nënshkruhet edhe prej tyre.

7. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet vendimmarrjes. Vendimet e komisionit janë të vlefshme kur merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet janë të dokumentuara në formë shkresore dhe nënshkruhen nga kryetari i komisionit dhe vulosen me vulën e Bashkisë së Tiranës.

8. Çdo dokumentacion i komisionit nënshkruhet nga kryetari dhe vulolet me vulën e Bashkisë së Tiranës dhe protokollohet në protokollin e Bashkisë së Tiranës. Dokumentacioni arkivohet dhe ruhet në arkivin e Bashkisë së Tiranës. Në përfundim të kësaj procedure vlerësimi dhe negociimi, sekretari i komisionit dorëzon në protokollin e Bashkisë së Tiranës të gjithë dokumentacionin e komisionit. Një kopje e dokumentacionit i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

III. THIRRJA PËR PALËT PRIVATE TË INTERESUARA

1. Në mbledhjen e tij të parë, komisioni harton thirrjen e hapur për palët private që janë të interesuara për të paraqitur një propozim për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.37/2018 dhe në këtë vendim, mbi bazën e termave të referencës të hartuar nga Bashkia e Tiranës.

2. Thirrja depozitohet në protokollin e Bashkisë Tiranë.

3. Bashkia e Tiranës kryen të gjitha procedurat e nevojshme për publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike të thirrjes së hapur për shprehjen e interesit nga çdo palë private e interesuar të propozimeve dhe dokumentacionit të kërkuar për zhvillimin e zonës urbane të teatrit. Thirrja publikohet dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

IV. KRITERET KUALIFIKUESE PËR PALËT PRIVATE TË INTERESUARA

1. Përzgjedhja e palës private që do të marrë përsipër realizimin e projektit të zhvillimit të zonës dhe të godinës së re të Teatrit Kombëtar bëhet sipas procedurës konkurruese, bazuar fillimisht mbi kriteret kualifikuese të përcaktuara në këtë kre dhe më pas ato vlerësuese.

2. Pala private e interesuar dorëzon dokumentacionin që vërteton se:

- a) nuk është në proces falimentimi;
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, sipas parashikimeve të legjislacionit për përgjegjësinë penale të personit juridik;
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- ç) ka plotësuar detyrimet fiskale;
- d) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore.

3. Pala private e interesuar duhet të vërtetojë se përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.37/2018, si dhe plotëson të gjitha kërkesat minimale të projektimit, sipas aneksit bashkëlidhur.

4. Pala private e interesuar duhet të ketë një xhiro vjetore shumatorja e së cilës për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 40% të vlerës së kostos së projektit të propozuar prej tij në këtë procedurë, dhe në vijim të thirrjes së hapur të paraqiten vërtetime nga administrata tatimore si dhe pasqyrat financiare të tria viteve të fundit.

5. Pala private e interesuar duhet të depozitojë të gjitha licencat profesionale dhe certifikimet e vlefshme, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Pala private e interesuar duhet të vërtetojë realizimin e projekteve të ngjashme gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të aktivitetit të tij, shumatorja e të cilave të jetë jo më pak se 40% e sasisë ndërtimore (m^2) totale të ofertuar prej tij në këtë procedurë në vijim të thirrjes së hapur. Realizimi i suksesshëm i punimeve duhet të vërtetohet me dokumentet, si më poshtë vijon:

- a) leje ndërtimi ose kontratë sipërmarrjeje;
- b) situacion përfundimtar;
- c) akt kolaudimi;
- ç) referenca nga punëdhënësi duke shprehur sasinë në m^2 ndërtim të realizuar.

7. Pala private e interesuar duhet të paraqesë sigurimin e ofertës në nivelin e 2% të vlerës së koston së projektit të propozuar prej tij në këtë procedurë në vijim të thirrjes së hapur.

8. Pala private e interesuar duhet të paraqesë analizën teknike, e cila duhet të përmbajë sfondin e projektit, konceptin e projektit, vendndodhjen, parcelat e prekura, sipërfaqen e përgjithshme publike e private të zbatimit të projektit, studimet topografike dhe gjeologjike, përshkrimin konstruktiv, funksional e teknik të projektit, ndikimet mjedisore dhe sociale, aksesueshmërinë nga automjetet dhe këmbësorët, periudhën e vlerësuar të ndërtimit të teatrit dhe analizën ekonomike e financiare.

9. Pala private në shprehjen e interesit duhet të vërtetojë se është pronare e truallit ose posedon marrëveshjet përkatëse me pronarët privatë, minimumi në masën 40% e sipërfaqes totale të pronës private që preket nga projekti i zhvillimit të zonës dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar. Projekti do të vlerësohet nga komisioni mbi bazën e sipërfaqeve të vëna në dispozicion nga shteti dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me subjektet, pronarë privatë.

10. Kërkesat sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, plotësohen me dorëzimin e ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, ekstraktit mbi historikun e subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit mbi gjendjen gjyqësore.

11. Dokumentacioni duhet të jetë i lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit të shprehjes së interesit nga pala private (me përjashtim të dokumentacionit që lidhet me pikat 5, 6, 8 dhe 10, të këtij kreu).

12. I gjithë dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje të noterizuara. Rastet e mosplotësimit të një prej kriterëve kualifikuese të mësipërme ose të mosdorëzimit të një dokumenti a të dokumenteve të rreme e të pasakta konsiderohen kusht për skualifikim.

V. KRITERET VLERËSUESE PËR PALËT PRIVATE TË INTERESUARA

1. Çdo palë private që kalon fazën kualifikuese, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur sipas përcaktimeve të kreut IV, të këtij vendimi, vlerësohet nga komisioni sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) kriterit teknik (me 70 pikë);
- b) kriterit ekonomik (me 30 pikë).

2. Komponentët e kriterit teknik, me një total prej 70 pikësh, zbërthehen, si më poshtë vijon:

a) Projektideja e zhvillimit të zonës (60 pikë), ku vlerësohen këto nënelemente:

- i. masterplan, zgjidhja e ofruar (pesha 20 %);
- ii. arkitektura e Teatrit Kombëtar (pesha 40 %);
- iii. organizimi i brendshëm (pesha 40 %).

b) Niveli (në %) i gëzimit të të drejtave mbi pronën, referuar sipërfaqes totale të pronës private që preket nga projekti (5 pikë);

c) Koha e realizimit të ndërtimit (5 pikë).

3. Komponentët e kriterit ekonomik, me një total prej 30 pikësh, i referohen ofertës për projektimin, ndërtimin, mobilimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin, dhe zbërthehen, si më poshtë vijon:

- a) çmim kosto teatri për m^2 , sipas koston së projektit të propozuar (10 pikë);

b) sasia (në %) e propozuar për m² pjesë takuese që do të përfitohet nga pala shtet (20 pikë).

4. Çdo palë private renditet nga komisioni sipas kriterëve të sipërpërmendura vlerësuese. Numri total i pikëve është 100.

VI. PROCEDURA DHE NEGOCIMI PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT

1. Komisioni studion e vlerëson propozimin dhe dokumentacionin e paraqitur nga palët private të interesuara për zhvillimin e projektit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 37/2018, dhe të kriterëve kualifikuese e vlerësuese të përcaktuara në këtë vendim.

2. Në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 6, të nenit 7, të ligjit nr. 37/2018, komisioni, në përputhje me kriteret kualifikuese dhe vlerësuese, shpall klasifikimin e palëve private të interesuara.

3. Komisioni, gjatë negocimit të kontratës me palën private, mund të asistohet nga një konsulent për marrjen e ekspertizave të specializuara, i përzgjedhur sipas procedurës së parashikuar në kreun VII, të këtij vendimi, që do të mund të kryhet nga Bashkia Tiranë.

VII. PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E KONSULENTIT

1. Kryetari i Bashkisë Tiranë ngarkohet me cilësinë e autoritetit kontraktor që të krijojë komisionin për ndjekjen e procedurave për përzgjedhjen me procedurë të veçantë të konsulentit për vlerësimin, përzgjedhjen, negocimin dhe lidhjen e kontratës me palën private.

2. Komisioni të përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, specialistë të fushave përkatëse të autoritetit kontraktor (juristë, ekonomistë dhe inxhinierë).

3. Komisioni do të kryejë identifikimin e shoqërive konsulente ose të bashkimit të shoqërive që ofrojnë shërbim në fushën e këshillimit juridik, financiar e teknik, bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme të bashkëpunimit të shtetit shqiptar dhe operatorët privatë me këto shoqëri, si dhe në vlerësimet e këtyre konsulentëve në publikime kombëtare e ndërkombëtare.

4. Ftesa për ofertë duhet të përmbajë specifikimin e objektit e të llojit të shërbimit të kërkuar, nevojën e kontraktimit të konsulentëve, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga konsulentët dhe datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit dhe:

a) në çdo rast, numri i shoqërive të identifikuara nuk duhet të jetë më i vogël se tre;

b) komisioni fton të gjitha shoqëritë që të paraqesin dokumentacionin për të provuar kapacitetin e tyre për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, brenda një periudhe jo më shumë se 7 (shtatë) ditë nga data e dërgimit të ftesës. Ftesa dhe kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbajnë elementet që përcaktohen në këtë vendim;

c) komisioni vlerëson kompanitë që përmbushin kriteret dhe i fton ato për paraqitjen e ofertës teknike dhe financiare;

ç) në përfundim të vlerësimit, komisioni harton një raport përmbledhës për zhvillimin e procedurës dhe ia paraqet për miratim titullarit të autoritetit kontraktor;

d) komisioni vazhdon vlerësimin edhe në rast të paraqitjes së një oferte/operatori ekonomik të vetëm, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për ofertë;

dh) në rast kualifikimi të një ose më shumë ofertave, komisioni i lë kohën e nevojshme, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë pune, ofertuesit/ofertuesve për paraqitjen e ofertës tekniko-financiare.

e) pas paraqitjes së ofertave/ofertës, komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune, bën vlerësimin përfundimtar dhe harton raportin përfundimtar sipas përcaktimit në shkronjën “ç”, të këtij neni.

5. Kriteret ligjore, teknike dhe financiare që duhet të plotësojnë ofertuesit/operatorët ekonomikë për pjesëmarrje dhe kualifikim janë, si më poshtë vijon:

a) të kenë dokumentacionin e regjistrimit në QKB ose një dokument ekuivalent për operatorët e huaj;

b) të kenë një vetëdeklarim që operatori nuk është në proces falimentimi dhe në ndjekje penale;

c) të kenë, të paktën, një kontratë për shërbim të ngjashëm, të realizuar brenda tri viteve të fundit, me vlerë investimi deri 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro;

ç) të kenë një përshkrim të detajuar të metodologjisë që do të përdoret për realizimin e shërbimit të kërkuar, të shoqëruar me një grafik të hapave që do të ndërmerren dhe afatet përkatëse;

d) të paktën njëra prej shoqërive të ketë eksperiencë në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas fushës së saj të ekspertizës.

6. Fondi limit përcaktohet nga Bashkia Tiranë dhe të jetë jo më shumë se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, me TVSH.

7. Ofertat e kualifikuara do të vlerësohen në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, sipas kriterëve të vlerësimit.

8. Operatorët duhet të paraqesin ofertat e tyre, në zarfe të mbyllura, të nënshkruara dhe të vulosura me shënimin:

- “Për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

- Të mos hapen para datës dhe orës së përcaktuar në ftesën për ofertë.

- Autoritetin kontraktues dhe adresën.

- Emrin e ofertuesit dhe adresën e tij, kontaktin telefonik, *e-mail*. Në ofertën e tyre konsulentët mund të deklarojnë që do të bashkëpunojnë me firma lokale për çështje të ndryshme teknike.

9. Ofertat hapen nga komisioni në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për ofertë. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nëse është në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe të ftesës për ofertë. Komisioni, brenda 3 (tri) ditëve pune, njofton dhe fton ofertuesit e kualifikuar për paraqitjen e ofertës teknike dhe financiare, ndërsa ofertuesit e pasuksesshëm për arsyet e skualifikimit.

10. Ofertuesi i skualifikuar ka të drejtën e ankimimit pranë titullarit të autoritetit kontraktor. Titullari i autoritetit kontraktor cakton një person për shqyrtimin e ankesës dhe i kthen përgjigje brenda 2 (dy) ditëve. Në rast se ankesa merret në konsideratë, operatorit i lihen në dispozicion 10 (dhjetë) ditë për përgatitjen e ofertës tekniko-financiare. Ky vendim i bëhet i ditur edhe operatorëve të tjerë të kualifikuar duke përcaktuar afatin e ri. Ankimimi nuk e pezullon procedurën e garës.

11. Pas miratimit të raportit përmbledhës nga titullari i autoritetit kontraktor, komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve, fton operatorin fitues të negociojë kushtet e kontratës. Çmimi si kriter i vlerësimit është kusht i panegociueshëm. Palët duhet të përfundojnë negociimin brenda 7 (shtatë) ditëve. Nëse dështojnë negociatat me operatorin fitues ose nëse ai tërhiqet, komisioni fton për negociim operatorin e radhës, nëse ka. Në rast se nuk mbetet asnjë ofertues në garë, autoriteti kontraktor do të rihapë garën.

12. Në rast të një procedure të suksesshme për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, komisioni i negociimit të kontratës vendos si kusht në kontratë, ndër të tjera, edhe detyrimin e palës private për t'i paguar autoritetit kontraktor vlerën përkatëse të paguar nga autoriteti kontraktor për konsulencën e dhënë nga operatori ekonomik fitues. Në rast se negociimi rezulton i pasuksesshëm, kostoja e ekspertizës mbulohet nga autoriteti kontraktor.

VIII. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Bashkia e Tiranës, Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

KRITERET E VLERËSIMIT – UDHËZUES

1. Komponentët e kriterit teknik, me një total prej 70 pikësh:

a) Projektideja e zhvillimit të zonës (60 pikë), ku vlerësohen këto nënelemente:

i. Masterplani, zgjidhja e ofruar (pesha 20%)

Pala private do të vlerësohet në bazë të konceptit të projektit të paraqitur dhe tërësinë e ideve që gjenerojnë formën finale të objektit dhe të hapësirave përreth tij.

Projektideja do të vlerësohet mbi bazën e marrëdhënies dhe të ndërveprimit të pjesës së eksterierit me atë të interierit.

- Planvendosja në terren e objekteve, duke marrë parasysh orientimin ndaj dritës, hijëzimin aty ku është e nevojshme, organizimin e sheshit

Faza e projektimit skematik dhe konceptual e cila do të sigurohet nga Pala Private:

- koncepti i objektit;
- masterplani shkallë 1:500;
- aksesueshmëria nga Automjetet dhe Këmbësorët;
- genplan i përgjithshëm i objektit dhe sistemimet e jashtme, shkallë 1–500;
- skemë distributive, organizimi i hapësirave të Teatrit;
- planimetritë e Teatrit, të të gjitha kateve të propozuara e të mobiluar, shkallë 1–200;
- të paktën 3 prerje A-A, shkallë 1–200;
- fasadat e objektit, shkallë 1–200;
- të paktën 4 imazhe render të jashtme, 2 imazhe render të hapësirave të brendshme;
- të paktën 1 aksionometri volumetrike ose render.

ii. Arkitektura e Teatrit Kombëtar (pesha 40 %)

Pala private do të vlerësohet duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Marrëdhënia me kontekstin urban dhe hapësirën publike ku projektidet e paraqitura do të vlerësohen për raportin e arkitekturës së propozuar me ndërtimet ekzistuese në terren si edhe rolin që ajo do të luajë në rivitalizimin e hapësirave publike ekzistuese dhe formësimin e hapësirave të reja;

- Marrëdhënia mes hapësirave të jashtme dhe hapësirave të brendshme ku vlerësimi do të bëhet mbi bazën e zgjidhjes së ofruar për një ndërveprimi sa më të mirë mes funksioneve të brendshme të Teatrit me funksionet e jashtme;

- Sipërfaqja totale e Teatrit të Ri Kombëtar, duhet të jetë jo më pak se 8000 m² ndërtim, ku hapësira për shfaqjet të përbëhet nga 3 salla (me një auditorium kryesor me të paktën 600 vende dhe dy salla eksperimentale (*blackbox*) me kapacitet minimumi 100 vende secila).

iii. Organizimi i brendshëm (pesha 40 %)

Pala private do të vlerësohet duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Zgjidhja e ofruar për organizmin funksional ku do të vlerësohet skema e organizmit funksional, auditorium, hapësira për aktorët/për publikun, recepsion, *foyer*, auditori i hapur, auditoret e vogla si edhe të gjitha hapësirave mbështetëse.

- Zgjidhja planimetrike ku do të vlerësohet organizimi i brendshëm dhe orientimi i hapësirave të brendshme.

- Skema e qarkullimit për publikun dhe artistët ku do të vlerësohet skema e aksesit të këtyre personave në ambientet e jashtme dhe të brendshme të Teatrit.

- Aksesueshmëria nga Automjetet dhe Këmbësorët do të vlerësohet aksesit i propozuar për automjetet e shërbimit dhe publikut si dhe aksesit nga këmbësorët.

b) Niveli (në %) i gëzimit të të drejtave mbi pronën, referuar sipërfaqes totale të pronës private që preket nga projekti (5 pikë)

$$Vlerësimi = \frac{Sasia \text{ (në \%) e pronave të lidhura nga ofertuesi}}{Sasia \text{ (në \%) më e lartë e pronave të lidhura nga ofertuesit}} \times 5$$

c) Koha e realizimit të ndërtimit (5 pikë).

$$Vlerësimi = \frac{Koha e realizimit të ndërtimit minimale e ofertuar.}{Koha e realizimit të ndërtimit e ofertuesit} \times 5$$

2. Komponentët e kriterit ekonomik, me një total prej 30 pikësh, i referohen ofertës për projektimin, ndërtimin, mobilimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin:

a) Çmim kosto Teatri për m², sipas kostos së projektit të propozuar (10 pikë)

$$Vlerësimi = \frac{\text{Çmimi minimal i ofruar kosto m2 teatr}}{\text{Çmimi i koston i ofertuesit}} \times 10$$

b) Sasia (në %) e propozuar m² pjesë takuese që do të përfitohet nga pala shtet (20 pikë).

$$Vlerësimi = \frac{Sasia \text{ (në \%) e propozuar pjesë takuese nga ofertuesi}}{Sasia \text{ (në \%) më e lartë e propozuar pjesë takuese nga ofertuesit}} \times 20$$

ANEKSI 2

MBI LICENCIMET DHE CERTIFIKIMET

1. Licenca Profesionale e Shoqërisë Ndërtuese, për realizimin e punimeve, sipas modelit të lëshuar nga Ministria përkatëse në kategoritë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 E Punime gjurmimi në tokë
- NP- 2 G Ndërtime civile dhe industriale
- NP-12 G Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-1 E Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-3 C Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- NS-4 G Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- NS-8 F Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- NS-9 G Punime strukturore speciale
- NS-10 G Shtresa dhe mbistruktura speciale
- NS-12 D Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- NS-14 F Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS-18 D Punime topogjeodezike
- NS-20 C Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2. Licencë për Restaurimin e Monumenteve të Kulturës kategoria “c”, lëshuar nga Ministria e Kulturës.

3. Licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKB-ja (Kodi III.2.A).

4. Licencë mbi grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuar nga QKB-ja (Kodi III.2.B).

5. Licenca profesionale për projektim (lëshuar nga ministria përkatëse), e vlefshme.

6. Pala private duhet të jetë e Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- ISO 9001-2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë);
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor);
- OHSAS 18001-2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë);
- ISO 39001-2012 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor).